



E DREJTA IME E VOTIMIT!

edukim dhe mobilizim i qytetareve/ëve
për mbrojtjen e të drejtës së votimit

www.civil.org.mk

E DREJTA IME E VOTIMIT

E drejta e zgjedhjeve të lira është e drejtë sovrane e të gjitha qytetareve dhe qytetarëve, e mbrojtur me Kushtetutë dhe me Ligjin Zgjedhor të Republikës së Maqedonisë dhe me të drejtën ndërkombëtare.

Zgjedhjet e lira janë kyçe për vendosjen e një demokracie konsistente dhe efektive të bazuar mbi sundimin e të drejtës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. E drejta e votës është në një lidhje thelbësore me të drejtën e lirisë së shprehjes, lirinë e fjalës dhe një sërë të drejtash të tjera të cilat u takojnë qytetareve dhe qytetarëve në mënyrë të barabartë.

E drejta e votës nuk është privilegj, ajo është e drejtë të cilën askush s'guxon ta marrë, as ta kufizojë apo ta manipulojë.

Me të drejtën e votës askush s'ka të drejtë të tregtojë apo ta kushtëzojë dëshirën e lirë të zgjedhësve me shërbime, dobi, para, siguri apo me përfitime të tjera, të drejta apo ndalesa.

Të drejtat dhe liritë e njeriut u takojnë të gjithëve, njëjtë sikur e drejta e votës. Këto të drejta s'mund të jenë objekt i tregtimit, kërcënimeve apo presioneve. Shkelja e të drejtës së votimit është sulm i drejtpërdrejtë mbi lirinë dhe demokracinë.

E drejta e votimit është e rrezikuar edhe me shkeljen e të drejtave të njeriut, me padrejtësitë sociale, manipulimet mediatic, diskriminimit në bazë të përkatësisë politike, me intervenimet demografike dhe nëpërmjet llojeve të ndryshme të dhunës strukturore në nivel lokal dhe qendror. Kjo duhet patjetër të ndalojë!

Çdo njeri ka të drejtën e punës, mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, arsimim dhe një sërë të drejtash dhe lirish të tjera.

Këto të drejta dhe liri askush nuk mund të t'i japë, apo të t'i marrë. Ato janë tuajat! Askush s'mund të të japë një gjë që tashmë të takon.

Kushtëzimet, presionet, ryshfeti dhe kërcënimet në këmbim me votën tënde në zgjedhje janë të pandershme dhe të ndaluara me ligj. Ti askujt s'i ke asnjë borxh.

Ryshfetin që ta ofrojnë do ta paguash shumëfish vetë, familja jote dhe bashkëqytetarët dhe bashkëqytetarët e tu.

Kundërshto kushtëzimet dhe manipulimet!

VOTO LIRSHËM!

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

Neni 22

Çdo qytetar me 18 vjet të mbushura e fiton të drejtën e votimit. E drejta e votimit është e njëjtë, e përgjithshme dhe e drejtpërdrejtë dhe realizohet në zgjedhje të lira me votim të fshehtë.

Ligji Zgjedhor

Neni 3

Askush s'guxon ta thërrasë zgjedhësin në përgjegjësi për shkak të votimit, e as nga ai të kërkojë të tregojë se për kë ka votuar apo pse s'ka votuar.

Ligji zgjedhor parasheh përgjegjësi penale për mashtrim zgjedhor dhe për lëndime të tjera të së drejtës së votimit.

Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut

Neni 21

Çdo njeri ka të drejtë të marrë pjesë në drejtimin e vendit të tij, drejtpërdrejt apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë të lirë. Çdo njeri ka të drejtë në qasje të barabartë të shërbimet publike në vendin e tij. Vullneti i popullit do të jetë baza e pushtetit, vullneti i popullit do të shprehet në zgjedhje të kohëpaskohshme dhe autentike, të cilat do të zbatohen, me të drejtë të përgjithshme dhe të barabartë të votës dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurave adekuate në zgjedhje të lira.

E DREJTA IME E VOTIMIT është projekt për forcimin e vetëdijes publike, edukim dhe mobilizim të qytetareve/ëve për përmirësimin e proceseve zgjedhore në Republikën e Maqedonisë, të bazuara mbi standardet demokratike përballë parregullsive zgjedhore. Ky projekt i përkushtohet rritjes së fuqisë së qytetareve/ëve në proceset zgjedhore dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut nëpërmjet njohjes së publikut me gjendjet me të drejtat e votuesve dhe me të drejtat dhe liritë e njeriut, në përgjithësi.

Civili formoi ekipe monitorimi anembanë vendit, të cilat do ta mbikëqyrin gjendjen dhe do të mbledhin informata nga qytetaret/ët për të gjitha format e keqpërdorimit.


Ekipet mobile të Civilit dhe ekipi i gazetarëve të Civil Medias çdo ditë do t'i kontrollojnë informatat dhe dëshmitë në terren dhe rregullisht do t'i publikojnë risitë, analizat dhe rrëfimet për gjendjet në terren.

**BASHKOHUNI!
SË BASHKU, DERI NË ZGJEDHJE TË LIRA!**

**Tani keni arsyen.
Tani keni vendin.**

**www.civil.org.mk
www.zgjedhjetelira.info**

Të gjithë qytetaret/ët e moshës së rritur të Republikës së Maqedonisë mund të marrin pjesë në projektin E DREJTA IME E VOTIMIT.



Njihuni me të drejtën e votimit dhe me të drejtat dhe liritë e njeriut, në përgjithësi. Këmbeni njohuritë tuaja me familjen, miqtë, fqinjët dhe më gjerë.

PARAQITNI fushatë të parakohshme, shkelje e të drejtës së votimit, propagandë agresive, punësime partiake, presione, kushtëzime, ryshfet, diskriminim, votues të paqenë, dhunë...

PARAQITJET JANË ANONIME

Shkruaj mesazhe ose paraqitu:

monitor@civil.mk

www.facebook.com/civil.mk

02 520 9176

075 565 830



Projekti E DREJTA IME E VOTIMIT është i përkrahur nga Projekti i USAID për shoqëri civile, të cilin e zbaton Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e Civilit dhe nuk i shfaq qëndrimet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.